



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Flori Rexhepi	04.12.2024	13.12.2024	2024/1166

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.12.2024, OE “TEHNOBURIMI” D.D., ka parashtruar ankesë me nr: 2024/1166, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pune ndertimore per zbatimin e projektit te hollesishem [zbatues kryesor], te arkitektures dhe inxhinierise, per ndertimin e Pishines Gjysme-Olimpikë, ne Podujeve, ne perputhje me rregulloret dhe udhezimet teknike, te miratuara nga ‘World Aquatics FINA’ me nr. të prokurimit: "207-24-8717-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, të negociuar, të kufizuar, lloji i kontrates: pune, vlera e parashikuar e kontrates: 4,000,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " TEHNOBURIMI " D.D.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpikë, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'" me numër të prokurimit: "207-24-8717-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi

Neni 7 Barazia në trajtim/ jo-diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënie të Kontratës

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 43 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

KRITERET PËR VLERËSIM

	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare		Kërkesa numër 1. Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe të kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure; dhe për këtë qëllim, duhet të	Dëshmitë për kërkesën nr.1 Raportet financiare dhe raportet e menaxhimit për secilin nga tre [3] vitet fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim [Në rast të Grupit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " TEHNOBURIMI " D.D.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpikë, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'" me numër të prokurimit: "207-24-8717-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

		dëshmojnë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, ka siguruar të ardhura minimale vjetore bruto, në shumën prej 8,000,000.00 € [Tetë milion euro].	të operatoreve ekonomik, udhëheqësi ('leader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] - Një [1] kopje e origjinalit.
		Kërkesa 2. - Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se disponon me kapital të mjaftueshëm për zbatimin e kontratës, qofte mjete të gatshme në llogarinë bankare OSE qasje në një kredi bankare, të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, përkatësisht në emër të këtij aktiviteti të prokurimit, në shumën prej 600,000.00 € [Gjashtëqind mijë euro].	Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 2.- Një [1] vërtetim nga një Bankë e kasës së parë, i cili dëshmon se Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, disponon me mjete të gatshme në llogarinë bankare, në shumën prej 600,000.00 € [Gjashtëqind mijë euro]. [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi ('leader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] - Një [1] kopje e origjinalit. OSE - Një [1] vërtetim nga një Bankë e kasës së parë, i cili dëshmon se Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, disponon me qasje në një kredi bankare të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, në shumën prej 600,000.00 € [Gjashtëqind mijë euro]. [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi ('leader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] - Një [1] kopje e origjinalit.
		Kërkesa 3 -Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvijës së mjaftueshme në sektorin përkatës; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për pune ndërtimore për zbatimin e projekteve të hollësishme [zbatues kryesore]- të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e	Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 3. - Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të dorëzoj dokumentacionin si në vijim - 'Kontratat dhe Raportet e pranimi teknik të punëve', të lëshuara nga autoritetet kontraktuese, publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave projekteve përkatëse [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " TEHNOBURIMI " D.D.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpikë, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'" me numër të prokurimit: "207-24-8717-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK

		<p>ndërtesave publike shoqërore [sipas kuptimit të paraqitur në vijim], në shumën prej 6,000,000.00 € [Gjashtë milion euro].</p>	<p>(‘leader’) i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] - Një [1] kopje e origjinalit. OSE - ‘Certifikatat Referencat e përfundimit të punëve’, të lëshuara nga autoritetet kontraktuese, publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave projekteve përkatëse [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi (‘leader’) i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] - Një [1] kopje e origjinalit. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 3. - Për të gjitha kontratat projektet e deklaruara, Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të plotësoj në tërësi Tabelën nr. 1, si dhe të njëjtës duhet të ia bashkëngjisë fotografitë e punëve të zbatuara, në jo me tepër se në katër [4] faqe [bashkërisht me Tabelën nr. 1] me madhësi A4 - Një [1] kopje e origjinalit. Sqarim i përkufizimit [Ndërtesat publike shoqërore] - Ndërtesat publike shoqërore, në rastin e kësaj lënde aktiviteti të prokurimit, nënkupton dhe përfshinë të gjitha tipologjitë e ndërtesave të sportit, të kulturës, të arsimit, të shëndetësisë, të administratës [nën-administrim pronësi shtetërore- lokale qendrore (brenda dhe jashtë Kosovës), nën-administrim pronësi të shteteve të tjera ose të organizatave ndërkombëtare (brenda dhe jashtë Kosovës)], të gjitha tipologjitë e ndërtesave të shërbimeve dhe tregtare [nën-administrim pronësi private], të gjitha tipologjitë e ndërtesave të banimit shumë-katesh, si të veçanta apo të kombinuara</p>
--	--	--	---


Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " TEHNOBURIMI " D.D.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'" me numër të prokurimit: "207-24-8717-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK

			me çfarëdo përmbajtje të tjera funksionale [nën-administrim pronësi private] dhe të gjitha tipologjitë e ndërtesave të industrisë dhe të magazinimit; ndërsa përjashton të gjitha tipologjitë e infrastrukturës së transportit dhe teknike dhe të tjerave të ngjashme [duke mos pasur parasysh formën e administrimit pronësisë], si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera hapësinore funksionale.
		Kërkesa 4- Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik është i obliguar që bashkërisht me dokumentacionin e tenderit të dorëzoj 'Programin ['Gantogram']'.	Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 4. 'Programi ['Gantogram']' duhet të përmbaj kalendarin e ndarë në baza javore [brenda afatit maksimal për përfundimin e kontratës, siç është përcaktuar më lartë, si dhe të gjithë artikujt e para-masës- ashtu siç janë përcaktuar në dokumentacionin teknik, përkatësisht të projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, duke përfshirë periudhën e fillimit dhe përfundimit të zbatimit për secilin artikull të para-masës, dhe të projektit në tërësi; ndërsa të njëjtin duhet ta dorëzoj në një [1] kopje, të nënshkruar dhe të vulosur.(Afati kohor maksimal per programin/ Gantogram është 550 dite kalendarike).

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " TEHNOBURIMI " D.D.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'" me numër të prokurimit: "207-24-8717-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullores dhe Udhëzimit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'

Nr. i prokurimit:	207-24-8717-5-1-1
Nr i brendshëm	207-24-075-511

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ²	Njoftimi për OE
1.	" TEHNOBURIMI " D.D., Shupkocë, 40000, Mitrovicë, Kosovë	3,812,122.92€	LS për GOE të eliminuar
2.	„Raf II”sh.p.k., Xhelal Hajda Toni, 21000, Kosovo, Kosovë	3,989,633.12€	LS për GOE të eliminuar
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik EURO - BESI SH.P.K.; ALPING SH.P.K., Muharrem Fejza, -, PRISHTINË, Kosovë	3,986,600.00€	LS për GOE të eliminuar
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik NIKA PrO- Ing SH.P.K.; Anion Mep Contracting, Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj, Kosovë	3,850,016.60€	LS për GOE të eliminuar
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik Olti Trasing SH.P.K.; SINANI - ING SH.P.K., Bill Clinton, 10000, PRISHTINË, Kosovë	3,718,440.74€	LS për GOE të eliminuar
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.; ECOPOOL SH.P.K., ARBËRI NORA E HOTIT,BLL.C2-10,OBJ."B"H1-4/2, -, PRISHTINË, Kosovë	3,945,895.60€	LS për GOE të eliminuar

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:
 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Nëna Terezi nr. 35 Prishtinë, bazuar në nenin 43.5 të Rregullores nr. 001/ 2022 për prokurimin Publik anulon aktivitetin e prokurimit me titull: Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA', pasi që asnjë prej ofertave të pranura nuk është i përgjigjshëm që i plotëson kushtet dhe kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Data: 11.11.2024
 Emri dhe mbijemri i ZPP: Shkelqim Bvtyqi
 Drejtor i Zyrës së Prokurimit- MKRS

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " TEHNOBURIMI " D.D.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpikë, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'" me numër të prokurimit: "207-24-8717-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - " TEHNOBURIMI " D.D.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, i pakënaqur me vendimin (B58), ka dorëzuar ankese ne OSHP, me pretendimin se nuk është bere vlerësimi i ofertave konform dispozitave ligjore të Ligjit per Prokurim Publik (LPP).

Eksperti shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues/MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK , pas perfundimit te vleresimit te ofertave i ka njoftuar operatoret ekonomik pjesmarres ne kete aktivitet te prokurimit, lidhur me rezultatin e vleresimit te ofertave. AK-MKRS, ne mungese të ofertave te pergjegjshme e ka anuluar ne teresi aktivitetin e prokurimit dhe njeherit operatorin ekonomik ankues (Tehno Burimi D.D), e ka njoftuar si tenderues te eliminuar me arsyetimin se:

Në paramasë nga AK është paraqitur forma si në vijim:

	REKAPITULLIM I TË GJITHA FAZAVE				
1.	PUNËT NDËRTIMORE				0.00
2.	PUNËT E KONSTRUKSIONIT TE PISHINES DHE SISTEMIT TE FILTRIMIT				0.00
3.	PUNËT E INSTALIMIT ELEKTRIK				0.00
4.	PUNËT E RRJETIT TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT				0.00
5.	PUNËT E INSTALIMEVE TË MAKINERISË				0.00
				GJITHSEJT	0.00
				TVSH (18%)	0.00
TOTALI ME TVSH					0.00

NGA OE është larguar pjesa:

		TVSH (18%)	0.00
TOTALI ME TVSH			0.00

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vepruar në përputhje me nenin 44.3 të Rregullores nr. 001/ 2 për Prokurimin Publik, ku oferta e tillë është konsideruar ofertë e papërgjegjshme pasi që O **TEHNOBURIMI " D.D.**, ka paraqitur çmimin e përgjithshëm duke e larguar pjesën e TVS së të cilën e ka paraqitur AK- MKRS në para masë dhe si e tillë nga AK- MKRS është vlerësuar ndërhyrje ne para masë andaj oferta është ofertë administrativisht papërgjegjshme.

Eksperti shqyrtues, sqaron se në ankesën e tij OE ankues, pretendon se ka ndodhur një leshim teknik me këte rast kërkon që të kualifikohet si devijim i vogël sipas nenit 59.4 të LPP-se, me arsyetimin se TVSH-ja është e llogaritur brenda totalit të cmimit të ofertes, pra sipas OE ankues bëhet fjale vetëm për një leshim teknik.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këte çështje, sqaron se operatori ankues, me ratin e aplikimit në këte aktivitet të prokurimit e ka dorezuar ofertën e tij, dhe në ofertën financiare të dorezuar ka nderhyr duke hequr një pjesë të saj, konkretisht rubriken e TVSH-se dhe totalit me TVSH, sic është paraqitur me lartë në tabel.

Eksperti shqyrtues, sqaron se vlera e TVSH-se, është e llogaritur në totalin e cmimit të dhënë, mirepo një veprim i tillë sanksionohet me nenin 44.3 të Rregullores për Prokurim Publik:

Neni 44.3: “Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendosë logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header” apo kudo tjetër në dokumentet standarde”.

Eksperti shqyrtues, vlereson se operatori ekonomik ankues ka vepruar në kundërshtim me nenin 44.3 të Rregullores për Prokurim Publik, të cituar si më lartë, andaj sipas dispozitës ligjore të cekur si më lartë, nuk qëndron pretendimi i OE ankues se kemi dorezuar oferte të përgjegjshme, sepse i njëjti ka nderhyr në paramas duke hequr/fshirë kolonën e paramasës.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " TEHNOBURIMI " D.D.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'" me numër të prokurimit: "207-24-8717-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **" TEHNOBURIMI " D.D.**

Florije Rexhepi

